



**UNDP**  
në Kosovë

# Përmbledhja e Pulsit Publik XXII


**DREJTIMI POLITIK**

**SIGURIA PERSONALE**

**DREJTIMI EKONOMIK**

**MJEDISI**

**COVID-19**



**PRILL 2022**

*Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve të anketës dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.*

## **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	07
Treguesit kyç të Pulsit Publik	09
Drejtimi politik	10
Siguria personale	12
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	13
Drejtimi Ekonomik	18
Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht	19
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat	21
Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë	23
Qëndrimet kundrejt votimit	25
Mjedisi	30
COVID-19	36
Metodologjia	39
Peshimi i totaleve të popullatës	40
Përlllogaritja e Indekseve	41

## ***Lista e tabelave***

Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë	10
Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së	16
Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së	17
Tabela 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë	24



## ***Lista e figurave***

Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës	11
Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike	12
Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë	12
Figura 4 Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	14
Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës	18
Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht	20
Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik	22
Figura 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat	23
Figura 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë	25
Figura 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	26
Figura 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	27
Figura 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	28
Figura 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti	28
Figura 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	30
Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër	31
Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	32
Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre	33
Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	34
Figura 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë	35
Figura 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	35
Figura 21 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor	36
Figura 22 Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	37
Figura 23 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19	38
Figura 24 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike	39

**Përmbledhja  
e Pulsit Publik  
XXII**

## Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja e Pulsit Publik është publikim gjashtëmujor që ofron një pasqyrë të dhjetë treguesve kyç të nxjerrë nga anketat përkatëse të opinionit, me të anketuar mbi moshën 18 vjeç në Kosovë.<sup>1</sup> Përmbledhja e Pulsit Publik XXII bazohet në anketën e opinionit të realizuar nga 6 deri më 24 prill 2022, me 1.306 të anketuar nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptimet për problemet zhvillimore me të cilat përballen qytetarët në Kosovë.

Niveli i kënaqshmërisë me performancën e ekzekutivit kapi vlerën 47.6%, çka përbën një ulje prej 0.4 pikë përqindjeje nga anketa e tetor-nëntorit (vjeshtë) 2021 kur kjo vlerë ishte 47.6%. Niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit është 52.6% (53.2% në vjeshtën 2021), ndërsa me punën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës është 54.4% (55.4% në vjeshtën 2021). Niveli i kënaqshmërisë me Presidenten kapi vlerën prej 58.4%, krahasuar me shkallën e kënaqshmërisë prej 55.2% të regjistruar në vjeshtën 2021. Rritje pati në shkallën e kënaqshmërisë me Gjykatat dhe Zyrën e Kryeprokurorit, në nivelin prej 39.1% dhe 37.1% përkatësisht, krahasuar me 33.9% dhe 34% përkatësisht në vjeshtën e vitit 2021.

Indeksi i Demokratizimit (ID) u rrit për 0.07 pikë (1.66) nga vjeshta 2021, kur kjo vlerë ishte 1.59 pikë. Nga ana tjetër, Indeksi i Besueshmërisë Ekonomik (IBE) është ulur për 0.54 pikë (0.98) nga vjeshta 2021, kur ishte 1.52 pikë. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër pak më i lartë i të anketuarve ishin të gatshëm të protestojnë për arsye politike në prill 2022 (37.6%) sesa në vjeshtën 2021 (35.6%). Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë një rritje të gatishmërisë për të protestuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës, por një rënie në mesin e serbëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Kjo vlerë në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte 39.4% krahasuar me 37.1% në vjeshtën 2021, dhe 6.7% në mesin e serbëve të Kosovës krahasuar me 7.1% në vjeshtën 2021, dhe 30% në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës krahasuar me 30.8% në vjeshtën 2021.<sup>2</sup> Pjesa më e madhe e të pakënaqurve me drejtimin politik në Kosovë ishte në mesin e shqiptarëve të Kosovës (43.2%), pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës (34.5%) dhe serbët e Kosovës (33.8%). Përqindja më e madhe e të anketuarve që nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur me drejtimin politik ishte të Kosovës ishte mes serbëve të Kosovës (57.1%). Në përgjithësi, 42.6% e të anketuarve ishin të pakënaqur dhe 23.16% ishin të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës.

<sup>1</sup> Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

<sup>2</sup> Për qëllimet e kësaj ankete të opinionit, termi "komunitete të tjera të Kosovës" përfshin ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës.

Gjetjet nga anketa e opinionit e prillit 2022 tregojnë rritje të ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit, me 80.4% që ndihen të sigurt kur janë jashtë, krahasuar me 73.6% në vjeshtën 2021. Të dhënat e zberthyer sipas gjinisë tregojnë një ndjenjë të barabartë për sigurinë mes femrave (80.5%) dhe meshkujve (80.4%). Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është ulur për 3.9 pikë përqindjeje, me 46.1% që ndihen të sigurt në prill 2022, krahasuar me 50.9% në dhjetor 2020. Në mënyrë të ngjashme me anketën e mëparshme, ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, me 88.5% (85% në vjeshtën 2021) që ndihen të sigurt kur janë në rrugë, ndjekur nga 81.6% e shqiptarëve të Kosovës që ndihen të sigurt jashtë (73.6% në vjeshtën 2021).

Anketa e Pulsit Publik e prillit 2022 hulumtoi edhe problemet më të mëdha me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketa e mëparshme në tri çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale, me çmimet e furnizimeve esenciale që zëvendësojnë problemet mjedisore si çështja e tretë më e madhe. Tri problemet madhore të raportuara gjatë kësaj ankete ishin papunësia (36.4%), varfëria (21.1%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (7.7%). Kujdesi shëndetësor (5.7%) dhe korrupsioni (5%) ishin ndër pesë problemet kryesore të identifikuara nga të anketuarit. Vlen të theksohet se krahasuar me vjeshtën e vitit 2021 (9.3%), shkalla e atyre që e konsideronin korrupsionin si problem madhor ka rënë për 4.3 pikë përqindjeje. Serbët e Kosovës e konsiderojnë papunësinë (20.5%), çmimet e shërbimeve komunale (14.8%) dhe furnizimin me energji elektrike (11.4%) si tri çështjet më madhore, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (48%), e ndjekur nga varfëria (20.5%) dhe problemet me hapësirat urbane (13%). Për shqiptarët e Kosovës, papunësia (36.5%), varfëria (21.9%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (8.1%) ishin tri problemet madhore në Kosovë. Gjithsej 75% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me vjeshtën 2021 kur këtë e besonin 73% e të anketuarve. Mesatarisht, 22% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, një rënie prej 1.6 pikë përqindjeje nga vjeshta 2021 (23.4%).

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, 9% e të anketuarve thanë se dinë shumë për këtë temë, 32.5% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 41.4% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 17.1% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, një rënie prej 10.4 pikë përqindje krahasuar me vjeshtën 2021 (27.5%).

Gjithsej 38.1% e të anketuarve besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime kundrejt 26.6% që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë. Gjithsej 76.7% e të anketuarve do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Gjithsej 62.5% e të anketuarve deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 48.1% deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik dhe 52.6% treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Gjithsej 35.5% janë shprehur të kënaqur me masat e marra nga kabineti ekzekutiv për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes [Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData](#).

## Treguesit kyç të Pulsit Publik

Anketa e opinionit e prillit 2022 ka treguar se mesatarisht, 48.4% e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 47% në vjeshtën 2021, 27.5% në dhjetor 2020 dhe 42.5% në prill 2020.

Kënaqshmëria me punën e Presidentes së Kosovës kapi vlerën 58.4%, krahasuar me 55.2% në vjeshtën 2021 dhe 63.7% në maj 2021. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit kapi vlerën 52.6% (53.2% në vjeshtën 2021 dhe 59.5% në maj 2021). Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv të Kosovës ishte 47.2% krahasuar me 47.6% në vjeshtën 2021 dhe 59.1% në maj 2021. Niveli i kënaqshmërisë me Kryetarin e Kuvendit ishte 55.4% (55.4% në vjeshtën 2021 dhe 59.2% në maj 2021), ndërsa kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës ishte 50.2% (50.3% në vjeshtën 2021 52.9% në maj 2021).

Rritje është vërejtur në nivelin e kënaqshmërisë me performancën e gjykatave (39.1%) krahasuar me 33.9% në vjeshtën 2021 dhe 34.6% në maj 2021. Ky është niveli më i lartë i kënaqshmërisë me performancën e gjykatave i regjistruar nga anketat e opinionit të Pulsit Publik. Rritje e ngjashme e kënaqshmërisë është shënuar edhe me Zyrën e Kryeprokurorit. Gjithsej 37.1% e të anketuarve kishin pikëpamje pozitive për punën e Kryeprokurorit, krahasuar 34% në vjeshtën 2021 dhe 30.8% në maj 2021. Ky është niveli më i lartë i kënaqshmërisë i regjistruar që nga prilli 2014, kur niveli i kënaqshmërisë me punën e Zyrës së Kryeprokurorit ishte 38.1%. Në përgjithësi, kënaqshmëria e qytetarëve me gjyqësorin tregon një rritje të qëndrueshme që nga viti 2019, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

# 48.4%



e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës

<sup>3</sup> Platforma për Vizualizimin e të Dhënave:

<https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjoiNTUzMzZjAtNmZIMC00NmQ2LTg3YjAtNmZmOWY2MTNiMTBliiwidCI6ImIzZTVkYjVILTISNDQtNDgzNy05OWY1LTc0ODhhY2U1NDMxOSIsImMiOjhh9>

ASKData është një platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>.

**Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë**


Treguesit Politik		Prill 2016	Tetor 2016	Tetor 2017	Maj 2018	Nëntor 2018	Maj 2019	Nëntor 2019	Prill 2020	Dhjetor 2020	Maj 2021	Nëntor 2021	Prill 2022	Trendi
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Kabineti Ekzekutiv	17.80%	20.20%	32.40%	30.00%	31.30%	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	
	Kryeminstri	18.30%	19.70%	42.30%	33.20%	35.10%	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	
Kënaqshmëria me legjlativin	Kuvendi	17.30%	18.90%	31.70%	32.90%	36.10%	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	
	Kryetari i Kuvendit	24.30%	24.90%	36.00%	31.50%	36.30%	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	
Kënaqshmëria me presidentin	Presiden-tja	45.70%	25.50%	37.60%	39.10%	38.40%	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	18.70%	22.10%	36.90%	31.20%	37.80%	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	
	Prokuroria	16.90%	16.30%	33.10%	29.90%	35.30%	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	

## Drejtimi politik

Përqindja e të anketuarve që janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës ka rënë për 7.5 pikë përqindjeje (23.2%) krahasuar me vjeshtën 2021 (30.7%), kur kapi nivelin më të lartë të kënaqshmërisë të regjistruar ndonjëherë nga anketat e opinionit të Pulsit Publik. Rrjedhimisht, është rritur numri i të anketuarve shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës dhe shkalla e pakënaqshmërisë ka arritur në 42.6%. Kjo ishte një rritje prej 9.4 pikë përqindjeje e shkallës së pakënaqshmërisë krahasuar me vjeshtën 2021 (33.2%) kur u regjistrua niveli më i ulët i pakënaqshmërisë nga anketat e opinionit të Pulsit Publik. Megjithatë, kjo shkallë e pakënaqshmërisë është më e ulët se në dhjetor 2020 (59.4%) dhe prill 2020 (69.6%). Numri i atyre që ishin neutralë është ulur (34.2%) krahasuar me vjeshtën 2021 (36.1) dhe majin 2021 (38.8%).

Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë dallime të vogla mes meshkujve dhe femrave sa i përket kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës, ku 23.9% e meshkujve dhe 22.3% e femrave janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Megjithatë, femrat duken të jenë më të pakënaqura (34.1%) sesa meshkujt (31.2%) me drejtimin politik të Kosovës. Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë ngjashmëri në nivelin e kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës mes shqiptarëve të Kosovës (23.8%) dhe komuniteteve të tjera të Kosovës (23%). Niveli i kënaqshmërisë në mesin e serbëve të Kosovës ishte pak më i ulët (8.1%) se në anketën e mëparshme (9.1% në vjeshtën 2021).

Niveli më i lartë i pakënaqshmërisë gjendet tek shqiptarët e Kosovës (43.2%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (34.5%) dhe serbët e Kosovës (33.8%). Përqindja e atyre që janë neutralë në vlerësimin e tyre për drejtimin politik të Kosovës është mjaft e lartë, me 57.1% të serbëve të Kosovës, 42.5% të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 32.8% të shqiptarëve të Kosovës që janë neutralë.



**Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës**

Numri i të anketuarve të gatshëm t'iu bashkohen protestave politike është rritur për 1.1 pikë përqindje që nga vjeshta 2021. Gjithsej 37.6% e të anketuarve janë të gatshëm t'iu bashkohen protestave politike në prill 2022 krahasuar me 35.6% në vjeshtën 2021. Ky numër është më i lartë se në dhjetor 2020 (30.6%), prill 2020 (33.6%) dhe nëntor 2019 (31.3%), por më i ulët se në maj 2019 (42.2%). Të dhënat e zberthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Koncretisht, 39.4% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 6.7% të serbëve të Kosovës dhe 30% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Krahasuar me vjeshtën e vitit 2021, gatishmëria e serbëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës për të protestuar për arsye politike ra pak nga 7.1% në 6.7% dhe nga 31% në 30% përkatësisht. Numri i shqiptarëve të Kosovës të gatshëm të protestonin për arsye politike u rrit për 2.3 pikë përqindje krahasuar me vjeshtën 2021 (37.1%).




Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

## Siguria personale

Për të matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet tregojnë një rritje të perceptimit të sigurisë për 6.8 pikë përqindjeje (80.4%) krahasuar me vjeshtën 2021 (73.6%). Niveli më i lartë i sigurisë u regjistrua në prill 2020, kur 86.3% e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt për sa i përket dhunës dhe krimit potencial.




Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë



Të dhënat e zberthyer sipas gjinisë tregojnë një ndjenjë të njëjtë për sigurinë mes femrave (80.5%) dhe meshkujve (80.4%). Perceptimi për sigurinë u rrit për 9 pikë përqindje te femrat krahasuar me vjeshtën 2021 (71.5%) dhe për 5 pikë përqindje te meshkujt (75.4%). Të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë një rënie të lehtë në perceptimin për sigurinë në mesin e serbëve të Kosovës, me 46.1% që ndihen të sigurt në rrugë. Perceptimi për sigurinë në mesin e serbëve të Kosovës në vjeshtën e vitit 2021 ishte 50.9%. Vlen të theksohet se perceptimi për sigurinë në mesin e serbëve të Kosovës ishte më i lartë se në maj 2021 (34.8%) dhe i ngjashëm me prillin 2020 (46.2%) dhe dhjetorin 2020 (46.2%), kur janë raportuar të dhënat për sigurinë. Në mënyrë të ngjashme me anketën e mëparshme, ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, me 88.5% (85% në vjeshtën 2021) që ndihen të sigurt kur janë në rrugë. Gjithsej 81.6% e shqiptarëve të Kosovës ndjeheshin të sigurt në rrugë, krahasuar me 73.6% në vjeshtën 2021.


## **Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike**

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2022 regjistroi një rritje në Indeksin e Demokratizimit (ID) dhe një rënie në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE). Më konkretisht, ID aktual u rrit për 0.07 pikë (1.66) nga vjeshta 2021, kur kjo vlerë ishte 1.59 pikë. Kjo shifër sugjeron se më shumë se gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë.

Ndryshe nga vjeshta 2021, kur shumica e qytetarëve kishin pikëpamje pozitive për perspektivat ekonomike të Kosovës (1.52 pikë), në prill 2022, më pak se gjysma e qytetarëve e kishin këtë perceptim pozitiv (0.98 pikë). Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, kjo shifër është gjithashtu më e ulët krahasuar me majin 2021, kur ishte 1.49 pikë.



<sup>4</sup>ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokracinë apo trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike.



**Figura 4** Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbërë nga një numër komponentësh që përdoren për të gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjet për këtë indeks mund të përgjigjen me “Po, plotësisht”, “Po, kryesisht”, “Jo aq shumë”, ose “Aspak”. Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjen me “Po, plotësisht” ose “Po, kryesisht” në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit e prillit 2022 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se me përjashtim të gjyqësorit, të gjithë komponentët e ID-së të listuar në Tabelën 2 kanë dëshmuar rritje krahasuar me vjeshtën 2021. Gjithsej 73.4% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 70.9% në vjeshtën 2021, 70.4% në maj 2021, 45.9% në dhjetor 2020, dhe 66.3% në prill 2020, duke bërë që ky të jetë komponenti i ID-së me vlerësimin më të lartë. Gjithsej 67.5% konsiderojnë se Kuvendi e monitoron performancën e ekzekutivit, krahasuar me 63% në vjeshtën 2021, 60.1% në maj 2020, 45.6% në dhjetor 2020 dhe 58% në prill 2019. Gjyqësori është komponenti i vetëm që ka shënuar rënie në krahasim me vjeshtën 2021 (44.9%) dhe përndryshe ka qenë komponenti me vlerësimin më i ulët, me 41.7% vlerësim pozitiv nga të anketuarit. Megjithatë, vlerësimi për gjyqësorin mbeti më i lartë se në maj 2021 (37.5%), por më i ulët se në nëntor 2018, kur u regjistrua vlerësimi më i lartë pozitiv (46%). Gjithsej 69.6% e të anketuarve konsiderojnë se mediat gëzojnë lirinë e shprehjes – duke shënuar rritje prej 8.9 pikë përqindjeje krahasuar me vjeshtën 2021 (60.7%) dhe ngjashëm me majin 2021 (69.2%), si dhe mbetet më e lartë se dhjetori 2020 (57.9%). Rritje është vërejtur edhe në perceptimet për rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të singertë të ekzekutivit, me 61.9% që besojnë se kjo është e vërtetë krahasuar me 55.6% në vjeshtën 2021, 56.6% në maj 2021, 45.8% në dhjetor 2020 dhe 50.7% në prill 2020.

Nivel i ngjashëm i kënaqshmërisë mund të vërehet me punën e qeverisjes lokale dhe atë të ekzekutivit qendror. Teksa e para shënoi rritje nga 54.9% në vjeshtën 2021 në 55.8% në prill 2022, e dyta shënoi rritje nga 49.3% në vjeshtën 2021 në 56.8% në prill 2022. Vërehet një rritje në përgjigjet pozitive në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me 63.1% përgjigje pozitive krahasuar me 58.1% në vjeshtën 2021. Në fund, krahasuar me vjeshtën 2021 (55.7%) vërehet një rritje prej 4 pikë përqindjeje edhe në përgjigjet në pyetjet nëse proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur (59.6%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike të prillit 2022 tregojnë se teksa shumica e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë përgjigjur me “po plotësisht” dhe “po kryesisht” në të gjitha pyetjet e komponentëve të ID-së, shumica e serbëve të Kosovës, ngjashëm me anketat e mëparshme, janë përgjigjur me “aspak” dhe “jo aq shumë”. Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë përgjigjur me “po plotësisht” dhe “po kryesisht” në të gjitha pyetjet e komponentit të ID-së, përveç asaj për gjyqësorin, ku 58% janë përgjigjur me “aspak” dhe “jo dhe aq shumë”.

Po kryesisht dhe Po plotësisht	Mars 2015	Shta 2015	Prill 2016	Tet 2016	Tet 2017	Maj 2018	Nën 2018	Maj 2019	Nën 2019	Prill 2020	Dhjet 2020	Maj 2021	Nën 2021	Prill 2022	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	26.20%	23.00%	30.30%	28.00%	44.60%	50.90%	53.70%	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	73.42%	
A e monitoron Kuvendi performancën e kabinetit ekzekutiv?	21.20%	21.80%	26.60%	30.80%	36.10%	46.70%	48.30%	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	67.47%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.60%	17.60%	21.00%	21.60%	31.20%	43.60%	46.00%	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	41.67%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	35.50%	46.50%	47.30%	42.30%	52.50%	52.80%	59.10%	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	69.60%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	19.50%	23.10%	32.10%	30.10%	34.30%	48.30%	57.50%	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	56.62%	61.89%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	23.30%	27.20%	28.90%	30.40%	34.00%	50.20%	49.20%	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	57.88%	55.82%	
A punon kabineti qendror ekzekutiv i Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	11.80%	15.50%	18.90%	17.90%	24.70%	39.90%	37.50%	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	56.78%	
A janë Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	23.50%	19.80%	31.70%	31.80%	41.40%	53.40%	60.50%	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	63.05%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë?	17.30%	15.40%	23.10%	23.80%	29.70%	46.90%	57.20%	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	59.63%	

Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Gjithsej 17.2% e të anketuarve kishin pritje të favorshme për të hyrat totale të familjes së tyre brenda gjashtë muajve të ardhshëm, që është vlerë pak më e lartë se në vjeshtën 2021 (15.9%). Vërehet rënie në këndvështrimin pozitiv në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet për të bërë biznes në Kosovë, me 7.3% që i konsiderojnë të favorshme – rënie nga 12.8% në vjeshtën 2021. Rënie e ngjashme krahasuar me vjeshtën 2021 (10.8%) vërehet në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet aktuale të punësimit, ku 6.3% i konsiderojnë si të favorshme. Në fund, vërehet një rënie në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet e ardhshme të punësimit – gjashtë muaj nga anketa e opinionit e prillit 2022 – gjithsej 10.5% i shohin si të favorshme, krahasuar me 15.9% në vjeshtën 2021. Si përmbledhje, komponentët e IBE-së sugjerojnë që më pak se gjysma e qytetarëve të Kosovës (0.98) kanë pikëpamje optimiste për ekonominë.

E favorshme	Mars 2015	Shta 2015	Prill 2016	Tet 2016	Tet 2017	Maj 2018	Nën 2018	Maj 2019	Nën 2019	Prill 2020	Dhjet 2020	Maj 2021	Nën 2021	Prill 2022	Trendi
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot?	15.10%	15.90%	23.40%	18.00%	22.40%	19.90%	18.80%	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	17.20%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit?	8.10%	8.30%	14.40%	13.10%	17.90%	18.50%	16.70%	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	7.30%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit?	5.00%	6.80%	10.30%	7.70%	17.10%	15.40%	15.90%	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	6.30%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?	6.00%	8.00%	14.00%	10.70%	18.70%	17.80%	23.30%	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	10.50%	

Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së

## Drejtimi Ekonomik

Ulja në perceptimet pozitive, krahasuar me vjeshtën 2021, mund të vërehet edhe në kënaqshmërinë e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës. Gjatë prillit 2022, 17.2% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës për dallim nga 22.2% në vjeshtën 2021 dhe 18.4% në maj 2021. Rrjedhimisht, numri i të pakënaqurve është rritur nga 44.6% në vjeshtën 2021 në 50.8% në prill 2022. Gjithsej 32% nuk janë as të kënaqur e as të pakënaqur. Për dallim nga vjeshta 2021, kur femrat ishin më të kënaqura me drejtimin ekonomik sesa meshkujt, në prill 2022 meshkujt duken më të kënaqur sesa femrat. Teksa 18.8% e meshkujve janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, vetëm 15.5% e femrave ndihen njësoj. Për rrjedhojë, 49.7% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 52% të femrave që ndihen njësoj. Të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë se niveli i pakënaqshmërisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës është 51.2%, kurse me serbëve të Kosovës është 35.7%. Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës duket se janë më të pakënaqurit me drejtimin ekonomik të Kosovës (54%). Rrjedhimisht, grupi më i kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës janë shqiptarët e Kosovës (17.8%), ndjekur nga të anketuarit nga komunitetet e tjera të Kosovës (14.5%), dhe serbët e Kosovës (7.6%).




Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

## Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

Anketa e Pulsit Publik e prillit 2022 hulumtoi edhe problemet më madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketa e mëparshme në tri çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenie, me çmimet e furnizimeve esenciale që zëvendësojnë mjedisin si çështja e tretë më madhore. Tri çështjet kryesore madhore të raportuara gjatë kësaj ankete të opinionit ishin papunësia (36.4%), varfëria (21.1%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (7.7%), ndërkohë që papunësia, varfëria dhe mjedisi ishin tri shqetësimet kryesore në vjeshtën 2021. Krahasuar me vjeshtën 2021, mjedisi (2.2%) ka rënë për 7.9 pikë përqindjeje. Shërbimet shëndetësore (5.7%) dhe korrupsioni (5%) ishin ndër 5 problemet kryesore me të cilat përballet qytetarët e Kosovës.

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se serbët e Kosovës e konsiderojnë papunësinë (20.5%), çmimet e shërbimeve komunale (14.8%) dhe furnizimin me energji elektrike (11.4%) si tri çështjet më madhore, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (48%), pasuar nga varfëria (20.5%) dhe problemet me hapësirat urbane (13%). Për shqiptarët e Kosovës, papunësia (36.5%), varfëria (21.9%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (8.1%) ishin tri problemet më madhore në Kosovë.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt dhe femrat janë kryesisht të shqetësuar për papunësinë, varfërinë dhe çmimet e furnizimeve esenciale. Ngjashëm me anketën e fundit të opinionit, femrat ishin më të shqetësuara për papunësinë (40%) sesa meshkujt (32.6%). Si femrat (20.2%) ashtu edhe meshkujt (21.8%) duket se janë njëjloj të shqetësuar për varfërinë. Megjithatë, meshkujt ishin më të shqetësuar për çmimet e furnizimeve esenciale (9.1%) sesa femrat (6.4%).



36.4%

**Papunësia**



21.1%

**Varfëria**



7.7%

**Çmimet**

e furnizimeve esenciale




Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht




## Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat


Anketa e opinionit e prillit 2022 tregon se 25% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse 75% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Gjetjet tregojnë një rënie të besimit në punësimin në baza meritore krahasuar me vjeshtën 2021 kur kjo shifër ishte 27%. Të anketuarit konsiderojnë faktorët vijues kryesorë për punësim në sektorin publik: lidhjet partiake (31.5%), lidhjet familjare (26%), arsimi (14.9%), ryshfeti (9.2%), shoqëria (6.4%), përvoja profesionale (6.3%), aftësimi profesional (3.7%) dhe, në masë më të vogël, paraqitja (1.6%), dhe gjinia (0.2%). Gjithsej 25% e të anketuarve besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorët më të rëndësishëm për sigurimin e punësimit në sektorin publik.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt kanë më shumë besim tek punësimi në baza meritore sesa femrat. Gjithsej 26.9% e meshkujve besojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me 23.1% të femrave që mendojnë të njëjtën gjë. Si për meshkujt (31.4%) ashtu edhe për femrat (31.7%), lidhjet partiake janë mënyra më e dobishme për punësim në sektorin publik.

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se lidhjet partiake duket se janë faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (32.1%) dhe serbët e Kosovës (32.9%), kurse për komunitetet e tjera të Kosovës janë lidhjet familjare (30.5%) që mundësojnë punësimin në sektorin publik. Ngjashëm me tri anketat e mëparshme (dhjetor 2020, maj 2021 dhe vjeshtë 2021), besimi më i vogël në punësimin në baza meritore gjendet mes serbëve të Kosovës (22%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (25%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (32.5%). Ngjashëm me anketën e fundit, këta të fundit kanë besimin më të lartë në punësimin në baza meritore, me arsimin, përvojën profesionale dhe aftësimin profesional si faktorë vendimtar për punësimin në sektorin publik.




Anketa e opinionit e prillit 2022 tregon se **25%** e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse **75%** mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore.



**Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik**

Krahasuar me anketën e vjeshtës 2021, besimi për punësimin në baza meritore në sektorin privat ka rënë nga 48.8% në 45%. Shumica e të anketuarve (54.9%) besojnë se punësimi në sektorin privat nuk bëhet në baza meritore. Ngjashëm me anketën e mëparshme, të anketuarit identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore për të siguruar punësim në sektorin privat: lidhjet familjare (30%), miqtë (13.8%), ryshfeti (6.3%), lidhjet partiake (3.7%), paraqitja e jashtme (1%) dhe, në masë më të vogël, gjinia (0.1%).

Të dhënat e zërthyerë sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (45.6%) dhe femrat (44.7%) kanë besim të ngjashëm në punësimin në baza meritore në sektorin privat. Të dhënat e zërthyerë sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime domethënëse mes komuniteteve në perceptimet rreth meritokracisë në sektorin privat. Më shumë besim në meritokraci si kriter për punësim në sektorin privat kanë pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës me 52.5% që kanë besim, pasuar nga shqiptarët e Kosovës me 45.3% dhe serbët e Kosovës, të cilët kanë më së paku besim në meritokraci me 39.9%.



**Figura 8** Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat

## ***Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë***

Mesatarisht, 22.2% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë paraqet rënie prej 1.2 pikë përqindje nga vjeshta 2021 (23.4%), 2.8 pikë përqindje nga maji 2021 (25%), 5.8 pikë përqindje nga dhjetori 2020 (28%) dhe një rritje për 1.5 pikë përqindje krahasuar me prillin 2020 (20.7%). Ky rezultat tregon një trend të qëndrueshëm pozitiv në perceptimin për korrupsionin në shkallë të gjerë krahasuar me vitet e mëparshme, siç tregohet në Tabelën 4.

Sektori i arsimit u perceptua si më pak i korruptuar me 12.1% që besojnë se ka korrupsion në shkallë të gjerë në shkolla dhe universitete, i ndjekur nga institucionet qendrore të Kosovës (13.9%), organizatat ndërkombëtare (14%) dhe Policia e Kosovës (14%). Organizatat më të korruptuara perceptohen të jenë Dogana (36.2%), ndjekur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) (32.6%) dhe Gjykatat (27.9%). Ndryshimet më të mëdha në perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Policia e Kosovës (14% krahasuar me 20.5% në vjeshtën 2021), institucionet qendrore të Kosovës (13.9% krahasuar me 19.5% në vjeshtën 2021) dhe sektori i arsimit (12.1% krahasuar me 16.8% në vjeshtën 2021).

Siç tregohet në tabelën e mëposhtme, tetë sektorë dhe organizata u perceptuan të jenë më pak të korruptuar sesa në vjeshtën 2021 dhe shtatë u perceptuan të jenë më të korruptuar se në vjeshtën 2021. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se perceptimi i meshkujve për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, ishte më i lartë se ai i femrave.

	Prill 2016	Tet 2016	Tet 2017	Maj 2018	Nën 2018	Maj 2019	Nën 2019	Prill 2020	Dhjet 2020	Maj 2021	Nën 2021	Prill 2022	Trendi
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	37.90%	49.70%	25.50%	32.50%	25.70%	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	18.10%	
KEDS	31.10%	31.40%	20.50%	33.00%	31.30%	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	25.80%	26.50%	
KEK									27.50%	25.30%	25.80%	26.70%	
Gjykatat	42.30%	49.30%	24.90%	38.60%	29.10%	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	27.90%	
Doganat	32.30%	45.20%	22.70%	39.10%	31.40%	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	36.20%	
Administrata qendrore/qeveria	36.60%	49.20%	30.70%	34.70%	28.40%	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	13.90%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	39.20%	45.70%	24.90%	34.50%	29.80%	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	32.60%	
Komunat (qeverisja lokale)	30.00%	40.20%	25.50%	29.00%	26.40%	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	16.30%	
Arsimi (shkollat, Universtiteti)	17.50%	31.00%	16.30%	26.20%	19.90%	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	16.80%	12.10%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	18.20%	32.50%	17.40%	28.90%	25.40%	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	28.80%	25.40%	
PTK	18.40%	29.60%	17.00%	27.80%	25.60%	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	27.70%	25.90%	
Bankat	23.10%	24.40%	13.10%	27.30%	26.10%	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	20.50%	
Organizatat Ndërkombëtare	16.00%	28.00%	10.80%	24.50%	10.70%	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	14.00%	
Policia e Kosovës (PK)	13.60%	21.10%	14.90%	25.70%	21.60%	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	14.00%	

**Tabela 4 Perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë**

Për të kuptuar se çka i formon perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyet për opinionin e tyre për shtrirjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të shkuarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (69.4%) i kanë formuar opinionet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron në Figurën 9 më poshtë. Gjithsej 27.2% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë formojnë bazën e opinionëve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa 3.4% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre iu janë kërkuat para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara. Vlera për këtë të fundit është ulur për 7.6 pikë përqindje krahasuar me anketën e vjeshtës 2021 (11%).





Figura 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë

## Qëndrimet kundrejt votimit


Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2022 hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Qëndrimet ndaj votimit kanë ndryshuar krahasuar me anketën e opinionit të vjeshtës 2021, duke treguar një rritje të besimit në efektin e votës së popullit për të shkaktuar ndryshime politike. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 38.1% e të anketuarve deklaruan se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 29.4% në vjeshtën 2021, 43.8% në maj 2021, 34.1% në dhjetor 2020 dhe 46.7% në prill 2020. Nga ana tjetër, 26.6% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, krahasuar me 36.1% në vjeshtën 2021, 25.1% në maj 2021, 27.4% në dhjetor 2020 dhe 26.8% në prill 2020.

Në prill 2022, 32.9% konsideronin se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në një farë mase, krahasuar me 31.2% në vjeshtën 2021 dhe 23.9% në maj 2021. Vetëm 2.3% nuk e dinin nëse vota e tyre mund të sjellë ndryshime apo refuzuan të përgjigjen.




**Figura 10** Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat ishin më pak të sigurta sesa meshkujt për fuqinë që ka vota e tyre të sjellë ndryshime në Kosovë. Ndërkohë që 40.1% (32.2% në vjeshtën 2021) e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 35.9% (26.5% në vjeshtën 2021) e femrave mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 25.2% e meshkujve dhe 28% e femrave besojnë se vota e tyre nuk mund të sjellë ndryshime, ndërsa 32.3% e meshkujve dhe 33.6% e femrave mendojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku.




**Figura 11** Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet komuniteteve në Kosovë në besimin e tyre tek zgjedhjet si mekanizëm ndryshimi. Në përgjithësi, vërehet një rritje e besimit tek vota e tyre si mekanizëm për ndryshim tek shqiptarët e Kosovës, dhe në masë më të vogël tek serbët e Kosovës, ndërsa vërehet rënie në besimin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjithsej 6.7% e serbëve të Kosovës (5.7% në vjeshtën 2021 dhe 2.4% në maj 2021) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, përkundëjt 15% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (30% në vjeshtën 2021 dhe 16.9% në maj 2021) dhe 40.5% e shqiptarëve të Kosovës (30.8% në vjeshtën 2021 dhe 48.2% në maj 2021). Ndërkohë që gjithsej 52% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime (37% në vjeshtën 2021 dhe 47.3% në maj 2021), të njëjtën gjë e mendonin edhe 24.8% e serbëve të Kosovës (19% në vjeshtën 2021 dhe 34.8% në maj 2021) dhe 25.6% e shqiptarëve të Kosovës (37.7% në vjeshtën 2021 dhe 22.9% në maj 2021). Ashtu si në anketën e vjeshtës 2021 dhe majit 2021, më i larti është numri i serbëve të Kosovës që besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku (59.5%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (32%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (25.5%).



**Figura 12** Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Anketa e Pulsit Publik e prillit 2022 hulumtoi edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, si dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 76.7% e të anketuarve (krahasuar me 77.6% në vjeshtën 2021 dhe 75.3% në maj 2021) do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në një të ardhme të afërt. Në mënyrë identike me rezultatet e anketës së vjeshtës 2021, 6.8% e të anketuarve nuk kishin ndonjë preferencë politike (krahasuar me 7.4% në maj 2021), 11.1% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin (krahasuar me 10% në maj 2021) dhe 5.4% refuzuan të përgjigjen.




**Figura 13** Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti



Ngjashëm me anketat e mëparshme, të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se më shumë meshkuj se femra do të kishin votuar nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Më konkretisht, 81.1% e meshkujve dhe 76.8% e femrave do të kishin votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin në të ardhmen e afërt. Në vjeshtën e vitit 2021, këto shifra ishin 78.3% për meshkujt dhe 75.2% për femrat, ndërsa në maj 2021 ishin 83.7% për meshkujt dhe 82% për femrat. Këto shifra janë të dyja më të ulëta se në dhjetor 2020, kur 93.4% e meshkujve dhe 92.2% e femrave deklaruan se do të votonin.


Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë një rënie të lehtë të gjasave për të votuar te serbët e Kosovës (52.4%) krahasuar me vjeshtën 2021 kur 57.6% e tyre thanë se do të votonin. Gjithsej 42.9% e serbëve të Kosovës thanë se do të votonin në maj 2021 dhe 59.1% kishte gjasa të votonin në dhjetor 2020. Shqiptarët e Kosovës shfaqën pak ndryshim në gjasat e tyre për të votuar (79.5%) krahasuar me vjeshtën 2021 (77.5%) dhe maj 2021 (77.3%). Megjithatë, këto shifra sugjerojnë një rënie krahasuar me 84.4% në dhjetor 2020. Më shumë pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës do të votonin në prill 2022 (88%) sesa në vjeshtën 2021 (78%) dhe maj 2021 (70.2%), por më pak se në dhjetor 2020 (89.4%). Vetëm 6.9% e shqiptarëve të Kosovës (6.9% në vjeshtën 2021, 5.8% në maj 2021 dhe 9.2% në dhjetor 2020), 5.7% e serbëve të Kosovës (5.7% në vjeshtën 2021, 14.8% në maj 2021 dhe 16.7% në dhjetor 2020), dhe 4.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (6% në vjeshtën 2021, 9.5% në maj 2021 dhe 5% në dhjetor 2020) nuk kishin preferenca politike, ndërsa 9.6% e shqiptarëve të Kosovës (10.9% në vjeshtën 2021, 9.6% në maj 2021), 18.6% e serbëve të Kosovës (17.1% në vjeshtën 2021, 22.9% në maj 2021), dhe 6% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (9% në vjeshtën 2021, 9.5% në maj 2021) deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Gjithsej 23.3% e serbëve të Kosovës, pasuar nga 3.6% e shqiptarëve të Kosovës dhe 1.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje.



**Figura 14** Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike


## Mjedisi

Të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2022 tregon se ka një ndryshim tek qytetarët që pretendojnë më shumë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër në krahasim me vjeshtën 2021. Gjithsej 15.3% (7.9% në vjeshtën 2021 dhe 16.1% në maj 2021) thanë se dinë shumë për këtë temë, 25.5% (24.9% në vjeshtën 2021 dhe 32.7% në maj 2021) pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 40.7% e të anketuarve (39.7% në vjeshtën 2021 dhe 36% në maj 2021) thanë se dijnë pak për këtë temë. Gjithsej 18.5% (27.5% në vjeshtën 2021 dhe 15.2% në maj 2021) thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.




**Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër**

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 38.6% e serbëve të Kosovës, 34.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 17.1% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, çka (përveç mes serbëve të Kosovës) tregon ulje të mungesës së njohurive krahasuar me vjeshtën 2021 (14.8% e serbëve të Kosovës, 39.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 26.7% e shqiptarëve të Kosovës). Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve (38.6%) që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën. Serbët e Kosovës përfaqësojnë edhe pjesën më të madhe të të anketuarve me njohuri të pakta në lidhje me temën (29.5%). Pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës tregojnë përqindjen më të madhe të të anketuarve me njohuri të pakta për këtë temë (44%), ndërsa shqiptarët e Kosovës kryesojnë me njohuri të shumta për këtë temë (16%), pasuar nga serbët e Kosovës (6.2%) dhe pjesëtarët e komunitetet tjera të Kosovës (5%).




**Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike**

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2022 shqyrtoi edhe vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Teksa 9% (5.15 në vjeshtën 2021 dhe 11.9% në maj 2021) e të anketuarve deklaruan se ishin plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 73.9% (67.9% në vjeshtën 2021 dhe 70.7% në maj 2021) e të anketuarve deklaruan se kishin pak njohuri ose njohuri mesatare rreth këtyre kërcënimeve. Gjithsej 17.1% (27% në vjeshtën 2021 dhe 17.4% në maj 2021) e të anketuarve deklaruan se nuk kishin njohuri rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (8.9%) dhe femrat (9.1%) kanë njohuri të ngjashme për këtë temë. Kjo ngjashmëri lidhet edhe me njohuritë mesatare (32.9% tek femrat dhe 32.1% tek meshkuj), por pak më pak femra (39.9%) se meshkuj (42.9%) pretendojnë se kanë pak njohuri për këtë temë. Më shumë femra (18%) pohojnë se nuk kanë njohuri për këtë temë sesa meshkuj (16.1%).




**Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre**

Siç shihet në Figurën 18 më poshtë, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet mes njohurive të grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, si dhe dallimet me anketën e vjeshtës 2021. Gjithsej 32.4% e serbëve të Kosovës, 29.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe 16.1% e shqiptarëve të Kosovës, deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh krahasuar me anketën e opinionit të vjeshtës 2021, është rritja e numrit të serbëve të Kosovës (10.7%) që nuk kanë njohuri për këtë temë dhe rënia e numrit të shqiptarëve të Kosovës (26.3%) që nuk kanë njohuri për këtë temë. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (32.4%). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të atyre që kanë pak njohuri (45%), ndërsa shqiptarët e Kosovës janë të parët për zotërimin e njohurive mesatare (32.9%) për temën. Shqiptarët e Kosovës udhëheqin edhe në njohuritë e shumta në lidhje me këtë çështje (9.5%), pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (5.5%) dhe serbët e Kosovës (4.8%). Në vjeshtën 2021, serbët e Kosovës pretenduan më shumë njohuri për këtë temë, me 6.7%, krahasuar me 5.5% nga shqiptarët të Kosovës dhe 0.5% nga komunitetet e tjera të Kosovës.




**Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zbrërthyer sipas përkatësisë etnike**

Për të dytën herë radhazi, anketa e opinionit e Pulsit Publik hulumtoi edhe vetëdijesimin për ndryshimet klimatike. Gjithsej 17.8% (12.3% në vjeshtën 2021) besojnë se Kosova është e ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe 63.4% (49.7% në vjeshtën 2021) besojnë se është e ndikuar deri diku nga ndryshimet klimatike. Gjithsej 16% (30.7% në vjeshtën 2021) besojnë se ndryshimet klimatike kanë pasur pak ndikim, ndërsa 2.8% (7.3% në vjeshtën 2021) besojnë se ndryshimet klimatike kanë pasur shumë pak ndikim në Kosovë. Të dhënat e zbrërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime madhore ndërmjet opinionit të meshkujve dhe femrave për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë: gjithsej 83.2% e meshkujve (61.6% në vjeshtën 2021) dhe 79.3% e femrave (62.6% në vjeshtën 2021) besojnë se Kosova është shumë ose deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërsa 16.8% e meshkujve (38.3% në vjeshtën 2021) dhe 20.5% e femrave (37.4% në vjeshtën 2021) besojnë se Kosova është pak ose shumë pak e ndikuar nga ndryshimet klimatike.



**Figura 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë**


Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se 82.5% (62.7% në vjeshtën 2021) e shqiptarëve të Kosovës besonin se Kosova është e ndikuar shumë dhe deri diku nga ndryshimet klimatike, ndjekur nga 64.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (66% në vjeshtën 2021) dhe 64.3% e serbëve të Kosovës (51.9% në vjeshtën 2021). Këta të fundit udhëheqin (35.7%) në besimin se Kosova ndikohet pak dhe shumë pak nga ndryshimet klimatike (48% në vjeshtën 2021), pasuar nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (35.5% kundrejt 34% në vjeshtën 2021) dhe shqiptarët e Kosovës (17.5% kundrejt 37.4% në vjeshtën 2021).



**Figura 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike**

## COVID-19

Anketa e opinionit e prillit 2022 përmbante pyetje në lidhje me pandeminë COVID-19. Të anketuarit u pyetën së pari rreth ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Gjithsej 62.5% e të anketuarve (51% në vjeshtë 2021, 60.7% në maj 2021, 68.7% në dhjetor 2020 dhe 65.9% në prill 2020) deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 48.1% (43.9% në vjeshtë dhe maj 2021, dhe 46.9% në dhjetor 2020 dhe 40.7% në prill 2020) deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik. Gjithsej 52.6% (50.7% në vjeshtë 2021, 48.6% në maj 2021, 52.8% në dhjetor 2020 dhe 59% në prill 2020) treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Ashtu si në anketat e mëparshme, këto shifra sugjerojnë se situata e krijuar nga shpërthimi i COVID-19 në Kosovë ka pasur efekte të mëdha negative në mirëqenien ekonomike të të anketuarve, të pasuara nga efektet në shëndetin mendor dhe shëndetin fizik. Të dhënat e zberthyer sipas gjinisë tregojnë se në përgjithësi femrat janë prekur më shumë sesa meshkujt. Për sa i përket mirëqenies ekonomike, femrat (62.5%) ishin pak më të prekura se meshkujt (60.8%). Shëndeti fizik i femrave (50.1%) është prekur më shumë sesa ai i meshkujve (45.1%). Ndikimi i COVID-19 në shëndetin mendor të femrave (53.7%) ishte më i lartë se tek ai i meshkujve (50%).




**Figura 21** Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor

Të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndikimi negativ i COVID-19 në mirëqenien ekonomike është rritur mes shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, por është ulur mes serbëve të Kosovës: gjithsej 63.7% (51.9% në vjeshtën 2021) e shqiptarëve të Kosovës, 31.4% (38.6% në vjeshtën 2021) e serbëve të Kosovës dhe 51.5% (47% në vjeshtën 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës




raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 33.4% e shqiptarëve të Kosovës, 20% e serbëve të Kosovës dhe 40% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës u përgjigjën se nuk kishin pasur asnjë efekt në mirëqenien e tyre ekonomike për shkak të shpërthimit të COVID-19. Ndërkohë që 49.2% e shqiptarëve të Kosovës raportuan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në shëndetin e tyre fizik, të njëjtën gjë e raportuan edhe 18.6% e serbëve të Kosovës dhe 43% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Në të njëjtën kohë, 53.8% e shqiptarëve të Kosovës, 25.7% e serbëve të Kosovës dhe 33.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në shëndetin e tyre mendor.



**Figura 22** Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

Të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet qendrore të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat sugjerojnë një rritje të lehtë të nivelit të kënaqshmërisë në krahasim me anketën e opinionit të vjeshtës 2021. Më konkretisht, 35.5% e të anketuarve janë të kënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv të Kosovës, kundrejt 32.3 në vjeshtën 2021, 43.6% në maj 2021 dhe 78.8% në prill 2020. Niveli i kënaqshmërisë ishte më i ulëti në dhjetor 2020, kur vetëm 15% e të anketuarve ishin të kënaqur. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (37.3%) janë më të kënaqur me masat e marra nga kabineti ekzekutiv i Kosovës në përgjigje ndaj shpërthimit të pandemisë sesa femrat (33.8%). Po ashtu, niveli i pakënaqshmërisë është gjithashtu më i lartë tek femrat (31.2%) sesa tek meshkujt (26.7%).



**Figura 23 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19**

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë rritje të kënaqshmërisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, ndërsa ka rënie të kënaqshmërisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, krahasuar me anketën e opinionit të vjeshtës 2021. Gjithsej 36.9% (32.9% në vjeshtën 2021) e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur me masat e kabinetit ekzekutiv të Kosovës, pasuar nga 30% (44.5% në vjeshtën 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, ndërsa vetëm 10% (8.6% në vjeshtën 2021) e serbëve të Kosovës kanë shprehur kënaqshmërinë e tyre me masat e marra nga kabineti ekzekutiv i Kosovës për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Ka një rënie të lehtë të pakënaqshmërisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe rënie substanciale mes serbëve të Kosovës, ndërsa ka një rritje të lehtë të pakënaqshmërisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës në krahasim me anketën e opinionit të vjeshtës 2021. Gjithsej 29.3% (31% në vjeshtën 2021) e shqiptarëve të Kosovës janë të pakënaqur, ndjekur nga 31.9% (59% në vjeshtën 2021) e serbëve të Kosovës dhe 22% (20% në vjeshtën 2021) e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Komunitetet e tjera të Kosovës kryesuan në të qenit neutral (45.5%), pasuar nga shqiptarët e Kosovës (33.6%) dhe serbët e Kosovës (19.5%).




Figura 24 Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthëra sipas përkatësisë etnike

## Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në anketën e opinionit me 1,306 të anketuar në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare, të realizuar nga 6 deri më 24 prill 2022. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (ashkali të Kosovës, boshnjak të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës) Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes mat sasinë reale të ndryshimit.

## ***Peshimi i totaleve të popullatës***

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totale, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

**Shqiptarë të Kosovës: 88%;**

**Serbë të Kosovës: 6%;**

**Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.**

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

**Shqiptarë të Kosovës: 93%;**

**Serbë të Kosovës: 2%;**

**Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.**

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet të shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi.

Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

**Shqiptarë të Kosovës: 92%;**

**Serbë të Kosovës: 4%;**

**Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.**

## ***Përlllogaritja e Indekseve***

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelit e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe ato ekzekutive qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 deri në 1.5 do të thotë që shumica e të anketuarve konsiderojnë se demokratizimi nuk është në rrugën e duhur, kurse rezultati prej 1.5 deri në 3 do të thotë që shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.







**UNDP**  
në Kosovë

# **Përmbledhja e Pulsit Publik XXII**

**PRILL 2022**